




USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA




Group for Legal
and Political
Studies

APLIKIMI I AUDITIMIT SOCIAL NË KOSOVË

Manual Praktik për Organizatat e
Shoqërisë Civile të Nivelit Lokal



Maj 2020



“Mos pyet çfarë shteti mund të bëjë për ty;
pyet çfarë ti mund të bësh për shtetin tënd.”

— John F. Kennedy

Grupi për Studime Juridike dhe Politike është institut i politikave publike, i pavarur, jopartiak dhe jo-fitimprurës. GLPS është e vendosur në Prishtinë, Kosovë.

Misioni ynë është që të realizojmë studime profesionale të politikave në fushën e së drejtës, politikës dhe ekonomisë, si dhe të shtyejmë përpara zgjidhje politikash që adresojnë dështimet dhe/apo analizojnë problemet në fushat e caktuara profesionale.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS)

Rr. Rexhep Luci, 16/1,

10000 Prishtinë, Kosovë.

Uebfaqja: www.legalpoliticalstudies.org

E-mail: office@legalpoliticalstudies.org

Tel/fax.: +383 38 234 456

© Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Prill 2020.



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Group for Legal
and Political
Studies

APLIKIMI I AUDITIMIT SOCIAL NË KOSOVË

MANUAL PRAKTIK PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE
TË NIVELIT LOKAL



Maj 2020

Ky publikim është përgatitur nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike dhe është përkrahur nga Aktiviteti i USAID Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse në Kosovë (USAID TEAM). Pikëpamjet e autorit në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

PËRMBAJTJA

KONCEPTI I LLOGARIDHËNIES SOCIALE.....7

Pse organizatat lokale duhet t'a përqafojnë këtë ide?.....7

Pse institucionet publike duhet të përqafojnë këtë ide?.....7

PSE LLOGARIDHËNIA SOCIALE NË KOSOVË?.....9

DISA DETAJE MBI OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE NË KOSOVË...10

MJETET E LLOGARIDHËNIES SOCIALE10

PSE AUDITIMI SOCIAL?.....14

OShC-të LOKALE vs. AUDITIMI SOCIAL15

PSE ORGANIZATAT LOKALE MUND TË PËRFITOJNË NGA AUDITIMI SOCIAL?17

SI TË ZBATOHET AUDITIMI SOCIAL?18

FAZAT DHE HAPAT KONKRET18

FAZA 1 - Planifikimi18

HAPI 1: Definimi i fushëveprimtarisë së auditimit social18

HAPI 2: Krijo legjitimitet në komunitet.....20

HAPI 3: Identifikimi i anëtarëve të ekipit të auditimit social.....20

HAPI 4: Themelo ekipin e auditimit social.....21

HAPI 5: Plan the process.....	21
FAZA 2 – Procesi i Mbledhjes së Informacionit	22
HAPI 1: Themelimi zyrtar i Ekipit të Auditimit Social.....	22
HAPI 2: Hartoni indikatorët e matjes së performancës	22
HAPI 3: Organizo takime të rregullta të Ekipit të AS-së dhe vizita në terren...	24
HAPI 4: Identifikimi i përfaqësuesve komunal dhe organizimi i takimeve të rregullta me ta	25
HAPI 5: Mbledhja e fakteve dhe dakordimi mbi rezultatet finale	26
FAZA 3 – Dialogu publik dhe publikimi i të gjeturave.....	28
HAPI 1: Hartoni një strategji komunikimi për të publikuar të gjeturat e auditimit social.....	29
HAPI 2: Organizoni takime të shumta mes ekipit të as dhe përfaqësuesve komunal.....	29
HAPI 3: Rekomandohet të organizohet një diskutim publik përmbyllës me të gjithë akterët relevant.....	30
HAPI 4: Koordinoni dialogun publik midis qytetarëve dhe përfaqësuesve komunal.....	31
FAZA 4 – Përcjellja dhe ruajtja e momentin pas përfundimit të projektit	32
VLERËSIMI I RREZIQEVE DHE SFIDAVE: Cfarë duhet të ketë parasysh një organizatë lokale?	34
PËRFUNDIM.....	35

PSE KY MANUAL?

1. U mundëson organizatave lokale të shoqërisë civile në Kosovë që të rrisin rolin e tyre pjesëmarrës dhe të ndikojnë në procesin e vendimmarrjes në nivel komunal!

2. Ofron informacion të detajuar se si mjetet e llogaridhënies sociale - një qasje inovative në Kosovë - ndikojnë me sukses dhe përmirësojnë jetën e komunitetit!

3. Ofron një përmbledhje të shkëlqyeshme mbi parimet themelore të auditimit social, si dhe këshilla se si të vihet në praktikë!




KONCEPTI I LLOGARIDHËNIES SOCIALE


Pse organizatat lokale duhet t'a përqafojnë këtë ide?

Në shoqëritë e sotme, llogaridhënia sociale ndihmon krijimin e marrëdhënieve të drejtpërdrejta midis qytetarëve dhe shtetit.

Përmes llogaridhënieve sociale, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët mund të përfshihen drejtpërdrejtë në proceset e vendimmarrjes, duke rezultuar në përmirësime të mëdha lidhur me qasjen në të dhëna publike, vlerësimin direkt të shpenzimeve të fondeve publike, monitorimin më të detajuar të ofrimit të shërbimeve publike, si dhe investigimin dhe monitorimin e drejtpërdrejtë të proceseve të prokurimit publik të iniciativave të ndryshme, përmes aktivizimit qytetarë. Kjo metodë realizohet përmes veprimeve të përbashkëta të OShC-ve dhe qytetarëve që synojnë të mbajnë shtetin përgjegjës, duke patur edhe mbështetjen e palëve të tjera si media, dhe institucione të ndryshme relevante.



Pse institucionet publike duhet të përqafojnë këtë ide?



KONCEPTI I LLOGARIDHËNIES SOCIALE

Nga ana tjetër, institucionet e nivelit lokal në Kosovë mund të kenë përfitime të shumëfishta nga përdorimi i mjeteve të llogaridhënies sociale. Më konkretisht, duke përdorur këto mjete, autoritetet komunale mund të fuqizojnë më tej bashkëpunimin me komunitetin e tyre, duke i bashkuar forcat në zbatimin e nismave të ndryshme të cilat i shërbejnë të mirës së përgjithshme, si dhe drejtëpërdrejtë kontribuojnë në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve në përgjithësi. Për më tepër, me anë të përfshirjes së qytetarëve në hartimin dhe planifikimin e iniciativave komunale, autoritetet lokale rrisin transparencën dhe gjithëpërfshirjen

në procese të vendimmarrjes, dhe njëkohësisht mundësojnë të rrisin rolin pjesëmarrës të qytetarëve në planifikimin dhe zbatimin e politikave komunale. Më e rëndësishmja, duke angazhuar qytetarët gjatë periudhës së implementimit të projekteve të ndryshme, komunat dyfishojnë rolin e tyre mbikqyrës kundrejt kompanive të kontraktuara, dhe kështu, përmirësojnë ndjeshëm cilësinë e punës së shërbimeve të ofruara nga një palë e tretë. Padyshim, duke fuqizuar qytetarët përmes mjeteve të tilla, komunat rrisin efektivitetin, transparencën dhe qeverisjen e mirë, në mënyrë të konsiderueshme.

Mjetet e llogaridhënies sociale kërkojnë përfshirjen e drejtëpërdrejtë të organizatave të shoqërisë civile dhe komunitetit me qëllim të shprehjes së nevojës për shërbime më të mira publike dhe llogaridhënie më të lartë nga autoritetet lokale, të cilat për qëllim të fundit kanë përmirësimin e kualitetit të këtyre shërbimeve. Aktivizmi qytetarë mbetet thelbi i llogaridhënies sociale.

Padyshim, mjetet e llogaridhënies sociale po njihen gjithnjë e më shumë nga institucionet qeveritare dhe joqeveritare në të gjithë botën, si një formë demokratike në përmirësimin e përgjithshëm të ofrimit të shërbimeve dhe në sigurimin e transparencës.

METODAT E LLOGARIDHËNIES SOCIALE VËNË QYTETARIN NË THELB!

Eksiztojnë mjete të ndryshme të llogaridhënies sociale që përdoren kudo në botë. Këto mjete gjithnjë e më shumë po përdoren nga organizatat e shoqërisë civile gjithandej,

të cilat si qëllim përfundimtar kanë monitorimin e përdorimit (apo keqpërdorimit) të fondeve publike lidhur me cilësinë e shërbimeve të ofruara nga qeveritë komunale².

1 Department of Administrative Reforms and Public Grievances: "Mekanizmat e Llogaridhënies Sociale: një kornizë gjenerike". Në dispozicion në: https://darp.gov.in/sites/default/files/Social_Accountability.pdf

2 Grupi për Studime Juridike dhe Politike: Mjetet e Llogaridhënies Sociale si metodë për sukses në llogaridhënie", 2018. Linku: <http://www.legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2019/02/GLPS-USAID-TEAM-Monitoring-Report-SA-PETS.pdf>

PSE LLOGARIDHËNIA SOCIALE NË KOSOVË?

Llogaridhënia sociale bashkon si detyrimin e shtetit për të dhënë llogari për veprimet e tij, ashtu edhe të drejtën e qytetarit për t'a mbajtur shtetin përgjegjës.

Mjetet e llogaridhënies sociale janë më efektive kur ngrerthejnë qasje inovative dhe shërbejnë si urë lidhëse mes qytetarëve dhe institucioneve publike.



Komuniteti është gjithnjë e më i vetëdijshëm për të drejtat e tyre për t'u angazhuar në monitorimin dhe mbajtjen në përgjegjësi të përfaqësuesve të tyre, duke kërkuar një qeverisje më transparente dhe më të përgjegjshme. Nga ana tjetër, qeveritë po përballen me një presion në rritje për t'u bërë më të përgjegjshëm dhe më transparentë gjatë proceseve të vendimmarrjes.

PSE LLOGARIDHËNIA SOCIALE NË KOSOVË?

Mjetet e llogaridhënies sociale përdoren më së shumti në vendet e zhvilluara, ku kërkesa për qeverisje transparente është e vazhdueshme. Këto mjete llogaridhënese mundësojnë përfshirje të drejtëpërdrejtë të komunitetit në një dialog profesional me institucionet e tyre publike, për të siguruar që proceset dhe politikat e dakorduara në letër do zbatohen me efikasitet edhe në praktikë. Për më tepër, shumëllojshmëria e këtyre mjeteve u mundëson organizatave të shoqërisë civile dhe nismave të komunitetit që të rrisin rolin e tyre pjesëmarrës në proceset e politikbërjes, si dhe rritjen e bashkëpunimit me qeveritë lokale. Më e rëndësishmja, mjetet e llogaridhënies sociale inkurajonë aktivizmin qytetarë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të kontraktuara dhe ofruara nga qeveritë e tyre lokale.

Qëllimi i përgjithshëm i përdorimit të mjeteve të llogaridhënies sociale në Kosovë është përmirësimi i transparencës dhe efektivitetit të sistemit të prokurimit publik me anë të përfshirjes direkte të qytetarëve në procesin e llogaridhënies.

Në Kosovë, koncepti i llogaridhënies sociale mbetet gjërësisht i panjohur, dhe i prezentuar së fundmi nga një organizatë e shoqërisë civile, përmes një projekti pilot në vitin 2018³. Për më tepër, aktivizmi qytetarë mbetet dukshëm i ulët dhe në shumicën e rasteve nxiten nga organizata të konsoliduara të shoqërisë civile, kryesisht të nivelit qendror, sesa nga vet komuniteti. Thënë këtë, prezantimi i duhur i konceptit të mjeteve të llogaridhënies sociale mbetet thelbësor, dhe nëse aplikohet siç duhet, kontribuon në masë të konsiderueshme në forcimin e aktivizmit qytetarë në Kosovë, forcimin e demokracisë dhe rritjen e bashkëpunimit midis qytetarëve dhe vendimmarrësve.

Raporti i Vendit 2019 për Kosovën⁴ nënvizon se është arritur përmirësim në reformën e administratës publike, duke vënë theksin mbi një angazhim të dukshëm në rritjen e llogaridhënies së institucioneve publike. Rekomandimet e Komisionit Evropian në këtë raport janë përqendruar në nevojën për rritje të përgjegjësisë në sektorin publik duke krijuar një kornizë të qartë për llogaridhënie menaxheriale dhe delegim më të mirë të përgjegjësive në institucionet publike.

³ Po aty.

⁴ Komisioni Evropian: Raporti i Vendit për Kosovë 2019. Linku: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>

DISA DETAJE MBI OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE NË KOSOVË

Përdorimi i mjeteve të llogaridhënies sociale nga organizatat lokale të shoqërisë civile në Kosovë mbetet thelbësor në ngritjen e transparencës dhe përgjegjësisë së politikanëve të përzgjedhur. Kur aplikohen mjetet e llogaridhënies sociale, organizatat e shoqërisë civile mund të përfitojnë në shumë mënyra, duke rritur kapacitetet, rolin e tyre, dhe përmirësimin e bashkëpunimit me akterët institucional, duke promovuar kështu demokracinë pjesëmarrëse dhe qeverisjen transparente në Kosovë.


As argued in the previous sections, local and central governments can significantly benefit by social accountability in multiple ways, resulting in inclusiveness during policy-making process, enhanced transparency, better service delivery, and overall increased performance.

Kur disa nga mjetet e llogaridhënies sociale u përdorën për herë të parë në Kosovë, ato rezultuan të jenë shumë të dobishme në mbledhje të masave më të gjëra të qytetarëve. Për shembull, në Vushtrri, projekti ka arritur që të angazhojë më shumë se 30 qytetarë në tri grupe të ndryshme të Auditmit Social, të cilët u angazhuan vazhdimisht për qëllime të ngjashme dhe në bashkëpunim shumë të afërt me zyrtarët komunal. Si rezultat, mjetet e tilla kanë rezultuar të jenë shumë efektive në mbledhjen e grupeve më të mëdha të qytetarëve në një vend, në krahasim me çdo konsultim publik të thirrur ndonjëherë nga autoritetet komunale. Duke konsideruar këtë, mjetet e llogaridhënies sociale u mundësojnë autoriteteve lokale që të sigurojnë pjesëmarrje të kënaqshme në aspekte të ndryshme të interesit të përbashkët. Si të tilla, ato përfaqësojnë një platformë të shkëlqyer për qeveritë lokale për të paraqitur arritjet dhe rezultatet pozitive gjatë qeverisjes së tyre, të cilat më vonë mund të interpretohen pozitivisht gjatë një procesi zgjedhor, duke rezultuar në më shumë vota për të njëjtit.

DISA DETAJE MBI OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE NË KOSOVË

Përgjatë viteve, kemi qenë dëshimtarë se ka pasur përmirësime të konsiderueshme në lidhje me procesin e prokurimit publik në Kosovë. Sipas një raporti, viteve të fundit, procesi elektronik i prokurimit publik në Kosovë ka dëshmuar të ketë sjell përmirësime thelbësore në rritjen e transparencës së proceseve të prokurimit publik, si nga institucionet qendrore ashtu edhe nga ato lokale në Kosovë⁵. Sidoqoftë, nevoja për rritje të më tutjeshme të llogaridhënies dhe transparencës mbetet ende një parakusht për përmirësimin e vazhdueshëm të qeverisjes në të dy nivelet.

Ofrimi i duhur i shërbimeve publike rezulton me një mirëqenie të ngritur të qytetarëve dhe një imazh më të mirë për vendin, duke inkurajuar zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, si dhe investime të huaja direkte. Nga ana tjetër, qytetarët ende mbeten kryesisht të papërfshirë në monitorimin e autoriteteve lokale, dhe bashkëpunimi midis qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre komunal është ende në nivele shumë të ulta.



MJETET E LLOGARIDHËNIES SOCIALE

Larmia e madhe e mjeteve të llogaridhënies sociale **fuqizon qytetarët** që të përdorin metoda të ndryshme për të mbajtur përgjegjës qeveritë e tyre. Shumica e këtyre mjeteve u mundësojnë qytetarëve që të përfshihen direkt në monitorimin e aspekteve dhe proceseve të ndryshme, dhe në faza të ndryshme të zbatimit poashtu.



⁵ Instituti Demokratik i Kosovës (KDI): "Indeksi i Transparencës në Prokurim Publik 2018", fq. 9. Linku: <http://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2019/08/50-Index-Transparency-Index-in-public-procurement-2018-ENG-11.pdf>

MJETET E LLOGARIDHËNIES SOCIALE

Disa nga mjetet më inovative të llogaridhënies sociale përfshijnë:

AUDITIMI SOCIAL – Auditimi Social përfshin nisma monitorimi të inicuar dhe udhëhequra nga komuniteti. Ndërsa mjetet tjera të llogaridhënies sociale përfshijnë metoda të ndryshme, qytetarët mbeten aspekti kryesor gjatë zbatimit të aktiviteteve të auditimit social. Përmes auditimit social, qytetarët synojnë që të monitorojnë dhe përmirësojnë procese për të cilat janë ngritur shqetësime të shumta nga ana e komunitetit të një zone të caktuar. Nismat e auditimit social janë gjithëpërfshirëse dhe synojnë të themelojnë grupe të diversifikuara të monitorimit, për sa i përket gjinisë, moshës dhe profesioneve. Në thelb të tij, auditimi social dëshmon të jetë një mjet shumë motivues për fuqizimin dhe rritjen e angazhimit në komunitet për të kërkuar të drejtën e tyre themelore në përfshirje gjatë proceseve të politikbërjes, dhe kërkimin e përgjegjësive së shtuar nga ana e autoriteteve publike.



PYETËSORI PËR TË HULUMTUAR SHPENZIMIN E FONDEVE PUBLIKE (PETS) – PETS realizohet përmes zhvillimit dhe implementimit të sondazheve sasiore që projektohen për të hulumtuar dhe vlerësuar mënyrën se si alokohen dhe shpenzohen fondet publike nga qeveritë lokale dhe ato qendrore. Qëllimi përfundimtar i PETS është për të vlerësuar nëse fondet e alokuara janë menaxhuar siç duhet dhe kanë arritur qëllimin e tyre fillestar për komunitetin e një rajoni të caktuar. Përdorimi i PETS ndihmon në luftën kundër korrupsionit dhe keqpërdorimit të fondeve. Përmes përdorimit të PETS, organizatat e shoqërisë civile mund të dokumentojnë se fondet e shpenzuara arsyetohen përmes kualitetit të shërbimeve të ofruara, sepse analizat kryesisht zhvillohen për të vlerësuar nëse mjetet janë shfrytëzuar duke



konsideruar vlerën e tyre monetare. Monitorimi i shpenzimeve përmes metodës PETS ka rezultuar të jetë i efektshëm në ngritjen e llogaridhënies, veçanërisht në shpenzimin e fondeve publike, ofrimin e shërbimeve të duhura kundrejt vlerës financiare dhe në vendet në zhvillim, ka demonstruar të jetë një mjet shumë efikas në identifikimin e veprave të mundshme të korrupsionit dhe keqpërdorimeve financiare nga ana e institucioneve publike.

KARTA E QYTETARËVE (CR) – Karta e Qytetarëve ka origjinë nga administrata e kryeministrit britanik John Major⁶. Kartat e Qytetarëve janë dokumente publike të lëshuara nga autoritetet qeveritare dhe të shpërndara gjerësisht tek qytetarët, që përmbajnë informacion të detajuar se çfarë shërbimesh autoritetet po planifikojnë të ofrojnë në një periudhë të caktuar kohe. Edhe pse ky dokument si i tillë nuk ngërthen në vete ndonjë obligim ligjor, shume shpesh ai nënkuptohet si një marrëveshje publike mes qeverive lokale dhe komunitetit të tyre⁷. Si mjet, Karta Qytetare ka dëshmuar të jetë shumë efektive në informimin e drejtë të qeverive lokale mbi pritshmëritë dhe standardet e kërkuara nga komuniteti i tyre dhe në anën tjetër, u ofron qytetarëve informacione dhe afate kohore mbi shërbimet që ofrohen nga autoritetet lokale. Nëse aplikohet me sukses, Kartat e Qytetarëve paraqesin një mjet shumë efektiv në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj qeverive të tyre dhe forcimin e bashkëpunimit midis të dy palëve, përmes një qasje transparente.



⁶ Atlas Corps: "Karta Qytetare si Mjet i Llogaridhënies Sociale". Linku: <https://atlas Corps.org/citizens-charter-as-a-social-accountability-tool/>


⁷ Po aty.

MJETET E LLOGARIDHËNIES SOCIALE


KARTA E RAPORTIMIT QYTETAR – Karta e Raportimit Qytetarë (CRC) është mjet i llogaridhënies sociale që përdoret në shumë shtete, si ato në zhvillim edhe në shtetet e konsoliduara. Përdorimi i CRC u mundëson qytetarëve, si përfituesit kryesor, që të lidhen dhe bashkëpunojnë me autoritetet lokale, duke ju ofruar opinionin dhe vlerësimin e tyre mbi shërbimet publike të ofruara nga këta të fundit. Si mjet, Karta e Raportimit Qytetar nuk nënkupton anketim apo vlerësim të ngjashëm, por më shumë mbështetet në planifikim të saktë të mbledhjes së informacionit, vlerësimin qytetarë, analizimit të këtyre të dhënave dhe komunikimit të tyre tek palët e përfshira, me qëllim të përmirësimit të mëtutjeshëm të ofrimit të shërbimeve publike.

PJESËMARRJA NË PLANIFIKIM DHE HARTIM TË BUXHETIT – Ky lloj mjeti i llogaridhënies sociale u mundëson qytetarëve që të rrisin pjesëmarrjen gjatë fazës së planifikimit buxhetor, përfshirë procesin e vendimmarrjes dhe monitorimit të shpenzimit të fondeve publike pasi të miratohet buxheti komunal. Si i tillë, ky mjet u mundëson qytetarëve që të kanalizojnë nevojat e tyre dhe të bëhen më të zëshëm në mbështetje të shërbimeve të cilat ata i konsiderojnë më prioritare. Edhe pse shumica e komunave në Kosovë ftojnë qytetarët që të marrin pjesë gjatë planifikimit buxhetor, interesi i qytetarëve për t'u bërë pjesë e procesit mbetet shumë i ulët, pothuajse jo ekzistent.

PAKTI I INTEGRITETIT – Pakti i Integritetit është mjet i llogaridhënies sociale që mbështetet një marrëveshje të ndërsjellë midis qeverive vendore dhe palëve të përfshira në aktivitet, me qëllim që paraprakisht të bien dakord mbi parimet dhe standardet që duhet të zbatohen gjatë një procesi specifik të prokurimit. Kjo marrëveshje thekson në veçanti faktin që palët e përfshira në proces të zotohen që do shmangin çdo keqpërdorim të mundshëm apo vepër korruptive gjatë fazës së implementimit të një procesi të caktuar të prokurimit publik, apo gjatë ofrimit të një shërbimi.



PËRFITIMET NGA MJETET E LLOGARIDHËNIES SOCIALE



PSE AUDITIMI SOCIAL?

Si OSHC-të lokale mund të adaptojnë auditimin social, si një mjet inovativ i llogaridhënies sociale për të rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë institucionale.



Kosova ende po përballlet me mangësi të konsiderueshme në garantimin e ofrimit të duhur dhe efektiv të shërbimeve publike, me theks të veçantë në nivelin lokal. Duke qenë një shtet i ri, institucionet e Kosovës ende janë në proces të implementimit të reformave të ndryshme për të siguruar ofrimin e duhur të shërbimeve dhe politikave publike⁸. Një nga aspektet më problematike që theksohet rregullisht nga shoqëria civile dhe raportet ndërkombëtare mbetet mungesa e llogaridhënies dhe transparencës së institucioneve publike. Për më tepër, aktivitetet e monitorimit nga komuniteti në nivel lokal janë shumë të ulëta dhe ka nevojë për përmirësim të konsiderueshëm.⁹

Thënë këtë, bashkëpunimi midis autoriteteve lokale dhe komunitetit është në nivele të dobëta, ndërsa organizatat e shoqërisë civile në nivel lokal ballafaqohen me mungesë kapacitetesh që të përfshihen siç duhet në proceset e vendimmarrjes. Si pasojë, qeveritë lokale shumë shpesh nuk japin informacione të mjaftueshme mbi atë se si po shpenzohen fondet publike dhe nëse aktivitetet e prokurimit janë duke u zbatuar siç janë planifikuar në fillim.

Përderisa përfaqësuesit politikë në Kosovës janë vazhdimisht plot premtime për një transparencë të përmirësuar dhe një jetë më të mirë për komunitetet e tyre, auditimi social siguron që këto premtime të mbahen.

Auditimi Social është një mekanizëm me bazë në komunitet i cili ndihmon realizimin e një kontrolli të cilësisë nga poshtë-lartë dhe vlerëson performancën e shërbimeve publike të ofruara nga autoritetet shtetërore, qofshin ato të një komune të caktuara, apo të institucioneve qendrore.

Auditimi Social është një mjet i fuqishëm i llogaridhënies sociale që u mundëson organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve që të monitorojnë se si qeveritë po i shfrytëzojnë burimet publike, dhe nëse politikat dhe planet e hartuara komunale shëndrohen në realitet nga i cili qytetarët mund të përfitojnë drejtpërdrejtë.

Auditimi Social vlerësohet të jetë një nga format më inovative të llogaridhënies sociale që kontribuon direkt në rritje të transparencës institucionale, dhe një përdorim më të mirë të burimeve publike.

Në shtetet në zhvillim, auditimi social është treguar të jetë shumë i suksesshëm në mobilizimin e komunitetit kundrejt kërkimit të përgjegjësisë institucionale, për procese të ndryshme që udhëhiqen nga qeveritë lokale dhe që i shërbejnë të mirës së përgjithshme.

Vëmendja e shtuar e grupeve të auditimit social rrit ndërgjegjësimin e përgjithshëm mbi shërbimet publike të ofruara, dhe natyrisht, përmirëson cilësinë e qeverive lokale dhe administratës së tyre.

Përmes auditimit social, OSHC-të lokale arrijnë të bëhen më të zëshme në parandalimin e keqpërdorimit të mundshëm dhe korrupsionit, duke analizuar plotësisht të gjitha dokumentet në dispozicion dhe duke i krahasuar ato me realitetin në praktikë, përmes monitorimit të drejtpërdrejtë të zbatimit të një aktiviteti të caktuar të prokurimit në një nivel komunal.

Përfundimisht, auditimi social forcon demokracinë pjesëmarrëse përmes inkurajimit dhe fuqizimit të drejtpërdrejtë të aktivizmit qytetar, duke i bërë ata më të zëshëm mbi të drejtat e tyre kushtetuese për shërbimet dhe përfitimet që ata kanë të drejtë të marrin.


⁸ Komisioni Evropian, Raporti i Vendit për Kosovën 2019. Linku: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf> (pg. 9)

⁹ Kërkohet që qytetarët të marrin më shumë pjesë në vendimmarrjen për investimet kapitale. Linku: <https://ekonomia-online.com/uncategorized/kerkohet-qe-qytetarët-te-marrin-shume-pjese-ne-vendimmarrjen-per-investimet-kapitale/>

OShC-të LOKALE vs. AUDTIMI SOCIAL

Raporti i Vendit të KE-së 2019 për Kosovën vlerëson se është shënuar progres i rëndësishëm në rritjen e bashkëpunimit midis shoqërisë civile dhe institucioneve të nivelit qendror¹⁰. Megjithatë, i njëjti progres nuk u vlerësua për bashkëpunimin në nivel lokal, ku organizatat lokale mbesin të pabarabarta dhe më pak të përfshira në politikëbërje dhe proceset e vendimmarrjes në nivelin komunal.

Disa nga sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen organizatat e shoqërisë civile të nivelit lokal janë:



Duke marrë parasysh këto sfida të dukshme në nivelin lokal, monitorimi i punës së qeverive lokale është i mangët dhe mbështetet thellësisht në kapacitetet financiare dhe njerëzore të organizatave lokale. Me disa përjashtime, shumica e OShC-ve lokale përballen me kufizime të përditshme për të luajtur rolin e tyre primar për të cilin janë të mandatuara. Shumica e aktiviteteve të ndërmarra nga organizatat lokale nuk prodhojnë ndikimin e dëshirueshëm, kryesisht për shkak të mungesës së kapaciteteve.

Mekanizmat inovativ sikurse ato të llogaridhënies sociale mbeten gjerësisht të panjohura për OShC-të në nivel lokal në Kosovë. Megjithëse në raste të caktuara shoqëria civile në nivel lokal arrin të mobilizojë komunitetin, këto mobilizime janë zakonisht të pastrukturuara dhe shumë shpesh mungojnë rezultatet konkrete. Thënë këtë, ky Manual Paraktik do të shërbejë si një pikë fillestare e shkëlqyeshme për OShC-të lokale që të familiarizohen me konceptin e llogaridhënies sociale, dhe përfundimisht t'a vendosin atë në praktikë.

Koncepti i llogaridhënies sociale u prezantua për herë të parë në Kosovë gjatë vitit 2018. Më konkretisht, aktiviteti i USAID Komuna Transparente, Efikase dhe Llogaridhënëse në Kosovë përkrahu Grupin për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), një organizatë qendrore, me qëllim që kjo e fundit të angazhohet në një projekt pilot për përdorimin e dy mjeteve të llogaridhënies sociale, të aplikuara në komunat e Prishtinës dhe Vushtrrisë.

¹⁰ Komisioni Evropian, Raporti i Vendit për Kosovën 2019. Linku: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>

Në vitin 2018, GLPS testoi dy mjete të llogaridhënies sociale në komunat e Prishtinës dhe Vushtrrisë: Auditimit Social dhe Pyetësin për të Hulumtuar Shpenzimin e Fondeve Publike (PETS). Një një periudhë 9 mujore, përmes përdorimit të këtyre mjeteve, projekti arriti rezultate të shumta.

HISTORI SUKSESI



Në Komunën e Prishtinës, Ekipi i Auditimit Social ka arritur të bind komunën të shkëput kontratën me kompaninë e kontraktuar dhe të hap proces të ri të prokurimit për shkak të vonesave të shumta në përfundimin e punëve finale për një park rekreativ në qytet.

HISTORI SUKSESI



Në disa fshatra të Vushtrrisë, Ekipet e Auditimit Social kanë arritur të dakordohen me komunën për të siguruar vizita mjekësore të rregullta për nxënësit në shkolla, përfshirë shërbimet dentare çdo gjashtë muaj.



HISTORI SUKSESI



Si rezultat i aktiviteteve të auditimit social, tri shkolla në zona rurale të Komunës së Vushtrrisë tainimë janë të pajisuara me të gjitha masat e sigurisë. Tridhjetë (30) anëtarë të grupeve të Auditimit Social, të udhëhequr nga GLPS, kanë avokuar rregullisht pranë autoriteteve lokale që shqetësimet mbi mungesën e masave të sigurisë të adresohen nga ana e komunës.



HISTORI SUKSESI



Ekipet e Auditimit Social, bazuar në Rezultatet e dala nga PETS, kanë arritur që me sukses të rrisin intensitetin e monitorimit të Qendrave të Mjekësisë Familjare në të gjithë Komunën e Vushtrrisë.



HISTORI SUKSESI



Ekipet e Auditimit Social, bazuar në Rezultatet e dala nga PETS, kanë arritur që me sukses të rrisin intensitetin e monitorimit të Qendrave të Mjekësisë Familjare në të gjithë Komunën e Vushtrrisë.

PSE ORGANIZATAT LOKALE MUND TË PËRFITONJË NGA AUDITIMI SOCIAL?

Përfitimet nga shfrytëzimi i auditimit social në Kosovë janë të shumta, me veçanti për rritjen e rolit të OSHC-ve lokale, si dhe zërit qytetar që mbetet thelbi i kësaj metode.

Auditimi social, si mjet i llogaridhënies sociale, kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e relevancës së organizatave lokale të shoqërisë civile. Auditimi social përfshin iniciativa që drejtohen direkt nga komuniteti, dhe si rezultat fuqizon qytetarët që të rrisin rolin e tyre duke u siguruar atyre një mjet për t'i mbajtur përgjegjës qeveritë e tyre, jo vetëm një herë në katër vjet kur mbahen zgjedhjet, por rregullisht.

Ndërsa përdorin auditimin social, qytetarët kanë tendencë të bashkohen dhe mobilizohen në mënyrë që të vlerësojnë dhe monitorojnë performancën e qeverisjes lokale, politikat e saj dhe se si ato ndikojnë në komunitetin e një zone të caktuar.

Nëse shfrytëzohet në mënyrën e duhur nga ana e OSHC-ve lokale, auditimi social do t'u sigurojë atyre një platformë të strukturuar për të përfaqësuar në mënyrë të denjë komunitetin e tyre dhe për të rritur rolin e tyre në komunitet.



Auditimi social u mundëson OSHC-ve lokale që të përfshihen drejtpërdrejt në proceset e vendimmarrjes në nivelin komunal. Si rezultat, ata do të bëhen më aktivë dhe do të angazhohen në përmirësimin e qeverive lokale.

Për më tepër, auditimi social u siguron OSHC-ve lokale një gamë më të gjerë mjetesh në dispozicion në mënyrë që ndikojnë direkt dhe në mënyrë demokratike në sigurimin e më shumë mundësive të bëra realitet. Ndër të tjera, auditimi social u mundëson OSHC-ve që të identifikojnë dhe luftojnë mungesën e transparencës dhe llogaridhënies nga autoritetet lokale.

Në mënyrë të ngjashme organizatat lokale mund të identifikojnë më mirë keqmenaxhimin e mundshëm të kontratave komunale, vonesat dhe veprimet e mundshme korruptive. Si rezultat, organizatat mund të bëhen një faktor i rëndësishëm në zhvillimin e institucioneve më të mira dhe më efektive të qeverisjes lokale.



Përmes auditimit social, OSHC-të lokale do të jenë në gjendje të trajtojnë një nga çështjet më shqetësuese në Kosovë, zbatimin e ligjeve në praktikë.

Përmes auditimit social, organizatat lokale u mundësojnë qytetarëve një platformë të konsoliduar të komunikimit dhe marrjes në përgjegjësi të përfaqësuesve të tyre, mbi politikat, projektet e planifikuara dhe në zhvillim dhe kështu edukojnë qytetarët mbi rolin e tyre demokratik. Auditimi social është një mjet efikas i llogaridhënies sociale sepse i fuqizon grupet e marginalizuara që shpesh nuk përfshihen apo edhe gabimisht anashkalojnë në iniciativa të tilla.




Si i tillë ai ndihmon organizatat lokale të kenë ndikim më të madhë, duke përdorur të drejtën e tyre për t'u informuar mbi performancën e institucioneve publike dhe mënyrën se si po zbatohen politikat lokale. Meqenëse politikat zakonisht janë abstrakte, duke përdorur këtë mjet, me ndihmën e OSHC-ve lokale, komunitetet mund të përfshihen dhe informohen për mënyrën sesi këto politika po ndikojnë në shoqëri me anë të veprimeve konkrete.

Në thelb, auditimi social ndihmon OSHC-të lokale të veprojnë në mënyrë të pavarur, pasi aktivitetet e auditimit social janë jo partiake, gjë që mbetet parimi thelbësor i procesit. Meqenëse përmes auditimit social, organizatat lokale dhe komuniteti tentojnë të trajtojnë çështje që janë për të mirën e përgjithshme, ndikimi dhe lidhja me politikën konsiderohet të dëmshme dhe të ndaluara.

SI TË ZBATOHET AUDITIMI SOCIAL?

FAZAT DHE HAPAT KONKRET

Në mënyrë që auditimi social të jetë i suksesshëm, organizata implementuese duhet të marrë për bazë disa faza gjatë procesit të zbatimit. Që procesi të prodhojë rezultatet e duhura, organizata implementuese duhet të konsiderojë përfshirjen e të gjitha palëve të interesit në mënyrë që procesi të jetë sa më gjithëpërfshirës. **Auditimi social duhet të ketë një kornizë të qartë kohore të zbatimit, si dhe rezultate të planifikuara për secilën fazë të zbatimit. Ky Manual Praktik ofron udhëzime të hollësishme për secilën nga fazat e zbatimit të auditimit social.**



FAZA 1 - Planifikimi

Faza e parë shërben si periudha fillestare drejt krijimit të procesit të auditimit social. Gjatë kësaj periudhe, organizata implementuese duhet të fokusohet në identifikimin e fushëveprimit të procesit të auditimit social, të sigurojë të gjitha dokumentet përkatëse, dhe të identifikojë pjesëtarët potencial të ekipit.

Gjatë kësaj faze, organizata implementuese duhet të ndërmarrë të gjithë hapat e mëposhtëm:

HAPI 1: Definimi i fushëveprimit të auditimit social
(Krijimi i strukturës operacionale që auditimi social të kryhet me sukses, psh. Identifikimi i aktivitetit të prokurimit apo shërbimit për t'u monitoruar, etj.)

FAZA 1 - Planifikimi

CILAT JANË KRITERET QË DUHET KONSIDERUAR GJATË PËRZGJEDHES SË PROJEKTIT KOMUNAL PËR T'U MONITORUAR DHE VLERËSUAR?

Komunat në tërë Kosovën planifikojnë dhe realizojnë projekte të shumta gjatë një periudhe të caktuar kohore, prandaj përzgjedhja e duhur e një projekti të caktuar mbetet një proces mjaft sfidues dhe duhet të bazohet në kritere të sakta dhe të argumentuara mirë. Më konkretisht, ekipi i auditimit social duhet të jetë në gjendje që në mënyrë profesionale të arsyetojë mbi procesin përzgjedhës dhe mbi parimet mbi të cilat është bërë kjo përzgjedhje. Pra, cilat janë disa nga këto kritere kryesore që duhet konsideruar gjatë kësaj periudhe?



E para, dhe më e rëndësishmja, gjatë përzgjedhjes së një projekti të caktuar, **organizata implementuese duhet të informohet se kush e financon atë iniciativë apo projekt.** Në raste të tilla, gjithnjë rekomandohet që projektet e përzgjedhura për monitorim të jenë plotësisht të financuara nga ana e komunës përkatëse. Gjithsesi, nëse një projekt i caktuar është i rëndësishëm së lartë për komunitetin, i njëjti mund të monitorohet edhe po që iniciative e përbashkët (p.sh. e komunës dhe një ministrie të caktuar), megjithatë shumica e fondeve të ndara për këtë projekt duhet të jenë nga ana e komunës përkatëse.



E dyta, projekti i cili përzgjedhet për t'u monitoruar duhet të **relletojë në tërësi nevojat e një komuniteti të caktuar** dhe duhet t'i shërbejë të mirës së përgjithshme të një zone të tërë, sesa grupeve të caktuara. **Zakonisht, aktivitetet e auditimit social implementohet në zona më të vogla dhe në një periudhë kohore më të shkurtër.** Në shumicën e rasteve, organizatat lokale nuk arrijnë të angazhohen në projekte të mëdha përshkak të limiteve financiare dhe profesionale. Prandaj, të fillohet me projekte më të vogla është një qasje me realiste në kontekstin e Kosovës.



Organizata implementuese duhet të sigurohet që komuniteti të jetë konsultuar plotësisht gjatë procesit të përzgjedhjes së projektit për auditim social. Për ta bërë këtë, organizata duhet që së pari të identifikojë se cilat janë projektet e iniciuara nga komuna gjatë asaj periudhe të caktuar. Më pas, projekti duhet të klasifikohet nëse është: a. ofrim i shërbimeve, apo b. projekt infrastrukturor. Sapo të hartohet një listë e projekteve të mundshme, ajo duhet t'i shpërndahej komunitetit të zonave që mund të përfitojnë nga këto projekte, me qëllim të përzgjedhjes së përbashkët për monitorim të asaj iniciative për të cilën komuniteti ka shprehur më së shumti interes.

E treta, vendosni për afatin kohor. Organizata implementuese duhet të konsultojë Ekipin e Auditimit Social mbi gatishmërinë e tyre që të monitorojnë një projekt që është duke u zbatuar, apo një projekt i cili është përfunduar tashmë. Të dyja opsionet japin përfitime të ndryshme. Një projekt që është ende në një fazë zbatimi i lejon Ekipin të AS të shtyjë përpara ndryshime të mundshme që mund të rezultojnë më vonë me një rezultat përfundimtar më të mirë. Ndërsa një projekt i përfunduar tashmë i mundëson Ekipin të AS të vlerësojë plotësisht suksesin e përgjithshëm të projektit dhe ndikimin aktual që ai gjeneron për komunitetin lokal.

Metoda më e rekomanduar është që të zgjidhni një projekt i cili është në fazën përfundimtare me rreth 70% -80% të punës së përfunduar tashmë. Sidoqoftë, kjo përzgjedhje varet shumë nga lloji i projekteve/iniciativave aktuale që një komunë e caktuar implementon gjatë asaj periudhe kohore. Por ajo çfarë mbetet thelbësore, mbi të gjitha, është që organizata implementuese të dëgjoj me kujdes nevojat e komunitetit. Ndonjëherë, ata mund të jenë më të gatshëm për të monitoruar një projekt të përfunduar por për të cilin qytetarët mbeten të pakënaqur me performancën dhe nuk sjell përfitimet e dëshiruara për ta. Në thelb, nevojat e tyre janë aspekti më i rëndësishëm gjatë fazës së përzgjedhjes.

Përfundimisht, kriteret themelore gjatë përzgjedhjes së një projekti për auditim social duhet bazuar në:

- ✓ Nevojat e komunitetit
- ✓ Parregullsitë e mundshme me fonde publike dhe keqmenaxhimi
- ✓ Vonesa të mëdha që mund të demtojnë mirëqenien e përgjithshme të një komuniteti
- ✓ Nëse projekti është plotësisht apo kryesisht i financuar nga fondet komunale

Çfardo projekti/shërbimi që nuk është ofruar si duhet dhe komuniteti nuk përfiton në mënyrë të duhur.

HAPI 2: Krijë legjitimitet në komunitet

(Sigurohu që fushëveprimtaria dhe rezultatet përfundimtare të jenë të elaboruara mirë)

Për të krijuar legjitimitet në komunitet, organizata implementuese duhet së pari të gëzojë respekt dhe besueshmëri tek përfaqësuesit e saj. Në anën tjetër, organizata implementuese duhet të informojë në mënyrë të duhur anëtarët e komunitetit të caktuar mbi qëllimin e auditimit social dhe të inkurajojë pjesëmarrjen aktive që mbetet thelbi i zbatimit të suksesshëm të një procesi të auditimit social. Që komuniteti të përfshihet seriozisht gjatë procesit të zbatimit, organizata

lokale duhet të elaborojë në mënyrë profesionale mbi fushëveprimtarinë e procesit të auditimit social si dhe mbi rezultatet përfundimtare që pritet të arrihen përmes këtij procesi. Përfundimisht, organizata implementuese duhet t'i sigurojë komunitetit një platformë profesionale e cila do t'i mundësojë atyre të shprehin shqetësimet dhe të angazhohen bashkërisht që të njejtat të adresohen siç duhet nga qeveritë lokale.

HAPI 3: Identifikimi i anëtarëve të ekipit të auditimit social

(Siguro gjithëpërfshirje dhe diversitet, tako zërat aktiv në komunitet, kërko rekomandime, organizo forume publike)

Një nga aspektet kryesore gjatë kësaj faze është edhe identifikimi i anëtarëve të mundshëm të ekipit të auditimit social. Organizata implementuese duhet të sigurohet që ekipi i përzgjedhur të përfshijë zëra aktiv dhe përfaqësues, persona që gëzojnë respekt mbrenda komunitetit, dhe më e rëndësishmja, persona që janë të etur për t'u angazhuar gjatë gjithë zbatimit të auditimit social, në mënyrë që të arrihen rezultatet e dëshiruara për një jetë më të mirë në komunitetin e tyre. Një nga përparësitë e angazhimit

të një organizate lokale në procese të auditimit social është lidhja e tyre e ngushtë me komunitetin përshkak të aktiviteteve të tyre të përditshme në një zonë/komunë të caktuar. Si rezultat, organizatat lokale tanimë posedojnë informacion të qartë mbi sjelljen e këtij komuniteti dhe potencialin që disa pjesëtarë të caktuar mund të kenë për të sjellë shumë entuziazëm tek ekipi i auditimit social, duke konsideruar përvojën e tyre të përbashkët në iniciativa në të kaluarën.

Pra, cila është mënyra më e mirë për të identifikuar këta pjesëtarë të komunitetit që në të ardhmën mund të shërbejnë si faktor të ndryshimit?

- Identifikoni zonën ku do të zhvillohet projekti që do të monitoroni përmes auditimi social (p.sh. fshat, qytet, zonë / lagje më e vogël, etj.);
- Takohuni me Këshillin e Fshatit, nëse ekziston një i tillë. Disa fshatra kanë Këshill të qëndrueshëm dhe shumë aktiv të cilët rregullisht përfshihen në aktivitete të ngjashme;
- Identifikoni personat që janë më të zëshëm dhe vazhdimisht angazhohet për të siguruar një mirëqenie më të mirë për komunitetin e tyre;
- Organizoni takime individuale dhe në grup me anëtarë të komunitetit i cili pritet të përfitoj nga implementimi i projektit që po planifikohet të monitorohet përmes ekipit të auditimit social.


FAZA 1 - Planifikimi

Gjithmonë mbani mend:

- ✓ Ekipi i Auditimit Social duhet të jetë i diversifikuar, për sa i përket moshës, profesioneve dhe gjinisë. Gratë dhe grupet e marginalizuara rekomandohet fuqishëm që të bëhen pjesë e ekipeve të AS;
- ✓ Ekipi i Auditimit Social duhet të jetë i diversifikuar, për sa i përket moshës, profesioneve dhe gjinisë. Gratë dhe grupet e marginalizuara rekomandohet fuqishëm që të bëhen pjesë e ekipeve të AS)

Anëtarët e Ekipit të Auditimit Social nuk duhet të jenë në asnjë mënyrë të përfshirë apo lidhur me ndonjë parti politike, por duhet të jenë qytetarë të zakonshëm që janë të gatshëm të luajnë rol të rëndësishëm për të mirën e komunitetit të tyre.

Dy hapat e mbetur janë si më poshtë:



KËSHILLA SHITESË! – FAZA 1

- > Fillimisht, identifikoni të gjitha palët relevante të interesit, sidomos departamentet përkatëse brenda komunës;
- > Diversiteti mbetet thelbësor! Sigurohuni që njerëzit janë të moshave dhe profesioneve të ndryshme. Grupet e marginalizuara gjithashtu duhet të përfshihen, sa më shpesh që është e mundur;
- > Sigurohuni që keni arritur të merrni të gjitha dokumentet relevante që i duhen Ekipit të Auditimit Social;
- > Rregulla e artë “sa më shumë në numër, aq më i lartë ndikimi” është relevante. Mirëpo, gjatë auditimit social, cilësia e grupit e mund sasinë;
- > Sigurohuni që përfaqësuesit komunal dhe kompanitë e kontraktuara janë të përfshira qysh në fazën fillestare;
- > Përzgjedh projekte të cilat nuk ngërthejnë periudhë të gjatë zbatimit. Projektet të cilat kanë arritur në gjysmë të fazës së zbatimit apo janë gati të zbatuara rekomandohen më së shumti.

FAZA 2 - Procesi i Mbledhjes së Informacionit

STEP 1: Themelimi zyrtar i Ekipit të Auditimit Social

Sapo faza e planifikimit të ketë përfunduar, fillohet me fazën e dytë që është zbatimi i procesit të auditimit social. Gjatë kësaj faze, Ekipi i Auditimit Social, nën udhëheqjen e organizatës implementuese, do të fillojë periudhën e monitorimit të projektit të përzgjedhur për auditim. Për të filluar me procesin e auditimit social, organizata implementuese duhet të organizoj një takim zyrtar të themelimit të Ekipit të Auditimit Social. Gjatë këtij takimi inagurues, organizata implementuese duhet të qartësojë mandatin e ekipit, fushveprimtarinë, si dhe rezultatet që synohen të arrihen në fund të procesit. Në vazhdim, organizata duhet të informojë secilin anëtarë mbi fazat e zbatimit të auditimit social dhe rolin e tyre në secilën fazë.

Faza e dytë është faza më e gjatë dhe me më së shumti aktivitete. Ajo përfshin aktivitete të monitorimit direkt, vizita në terren, takime formale dhe jo formale, takime me përfaqësues të komunës, dhe më e rëndësishmja, shumë aktivitete të hulumtimit dhe analizimit të dokumenteve në dispozicion, me qëllim që të vlerësohet nëse ajo çfarë është dakorduar në marrëveshje po zbatohet në praktikë. Në fund të kësaj faze, Ekipi i Auditimit Social dhe organizata implementuese duhet të posedojnë mjaftueshëm informacione cilësore për të vlerësuar nëse projekti i përzgjedhur është zbatuar në mënyrë të duhur, qoftë ai projekt infrastrukturorë, ofrim i shërbimeve apo çfardo aktiviteti tjetër i prokuruar.

HAPI 2: Hartoni indikatorët e matjes së performancës

Një nga aspektet kryesore të suksesit të një procesi të auditimit social është të kesh një pasqyrë të qartë mbi procesin të cilin keni përzgjedhur të monitoroni dhe vlerësoni, dhe më e rëndësishmja, si do ta bëni këtë. Sapo ekipi të jetë konsoliduar, i njëjti duhet të mbledhet dhe së bashku të punojë në hartimin e një Formë të Indikatorëve Matës të Performancës për projektin komunal që do monitorohet. Forma mund të përfshijë sa më shumë indikatorë që janë të zbatueshëm për projektin që do monitorohet dhe duhet të ofroj një pasqyrë reale të vlerësimit të procesit të përzgjedhur, qoftë ai shërbim apo lloj tjetër projekti/aktiviteti prokurimi. Organizata implementuese duhet të sigurohet që gjatë hartimit të kësaj forme të gjithë anëtarët e ekipit janë konsultuar, pa përjashtime. Gjithashtu, gjithmonë rekomandohet që para finalizimit të Formës, ekipi të realizoj vizita në terren (nëse bëhet fjalë për projekt infrastrukturor), ose të testoj shërbimet (nëse bëhet fjalë për ofrim të një shërbimi të caktuar). Në këtë mënyrë, Ekipi i Auditimit Social ka një pasqyrë më të qartë mbi realitetin përmes vlerësimit direkt të situatës aktuale.

Edhe pse kjo matricë zhvillohet në fazë relativisht të hershme, ajo mund të pësoj ndryshime gjatë procesit të monitorimit, varësisht nga situata. Gjatë periudhës së monitorimit, ekipi mund të vlerësojë që disa indikatorë janë më pak të rëndësishëm se të tjerët dhe dinamika e ekzekutimit të punës gjatë procesit të implementimit mund të qoj deri në ndryshim të indikatorëve, madje edhe duke shtuar indikatorë të rinjë. Gjatë procesit të hartimit të Formës, ekipi duhet të analizojë të gjitha dokumentet dhe të dhënat relevante mbi projektin e përzgjedhur. Sapo Forma të jetë përfunduar, ajo duhet t'i shërbejë ekipit si bazë e monitorimit të mëtutjeshëm. Forma e Indikatorëve Matës të Performancës siguron që procesi i auditimit social është i strukturuar mirë dhe i bazuar në indikatorë të saktë për të matur performancën e aktorëve komunalë gjatë ekzekutimit të veprimtarive të tyre.

FAZA 2 - Procesi i Mbledhjes së Informacionit

Një shembull i Formës së Indikatorëve Matës të Performancës:


Indikatori 1	Plani i fizibiliteti është i përfunduar
Indikatori 2	Përzgjedhja e kompanisë fituese është bazuar në kriteret e paracaktuara me ligj
Indikatori 3	Kompania fituese është përzgjedhur në kohë
Indikatori 4	Stafi i kompanisë fituese është caktuar për projektin në fjalë
Indikatori 5	Projekti është implementuar në bazë të planit dinamik të paracaktuar në kontratë
Indikatori 6	Buxheti për implementim të projektit është planifikuar drejtë dhe është i bazuar në çmimet reale të tregut për këtë lloj projekti
Indikatori 7	Dinamika e punës është rritur
Indikatori 8	Komuna rregullisht monitoron implementimin e projektit
Indikatori 9	Ekipi i Auditimit Social monitoron rregullisht implementimin e projektit
Indikatori 10	Takime të rregullta (çdo gjashtë javë) mes anëtarëve të ekipit të auditimit
Indikatori 11	Takime të rregullta (4 takime) mes anëtarëve të Ekipit të AS dhe përfaqësuesve komunal
Indikatori 12	Efikasiteti dhe përpjekjet e Departamentit të Prokurimit brenda komunes janë koordinimin, komunikimin dhe përmasimin e misionit të Ekipit të AS
Indikatori 13	Së paku 500 qytetarë të kënaqur me implementimin e projektit
Indikatori 14	Zona "Blok pas Blloku" është plotësisht funksionale dhe po përdoret nga banorët
Indikatori 15	Mirëmbajtja e parkut rekreativ "Blok pas Blloku" është duke u realizuar rregullisht



HAPI 3: Organizo takime të rregullta të Ekipit të AS-së dhe vizita në terren

Në mënyrë që auditimi social të jetë i suksesshëm, organizata implementuese duhet të koordinojë takime të rregullta të Ekipit të Auditimit Social. Zakonisht rekomandohet që këto takime të mbahen në Sallën e Asamblesë Komunale, kurdo që është e mundur. Edhe pse numri i takimeve paracaktohet qysh në fazat e hershme, grupi duhet të jetë fleksibil dhe t'i përshtatet nevojave të monitorimit. Vëllimi i takimeve varet shumë edhe nga zhvillimet gjatë fazës së monitorimit. Edhe nëse të gjithë anëtarët nuk janë prezent në një takim, organizata implementuese duhet të shpërndaj shënimet nga takimi me të gjithë anëtarët, përfshirë ata që nuk ishin prezent. Duhet kuptuar që pjesëmarrja e qytetarëve në një ekip të tillë është krejtësisht në baza vullnetare dhe nuk duhet të bie ndesh me angazhimet e tyre profesionale dhe personale. Një nga sfidat kryesore gjatë periudhës së implementimit të auditimit social mbetet mbajtja aktive dhe inspirimi i anëtarëve të ekipit, duke konsideruar faktin se ata nuk kompenzohen në asnjë mënyrë për angazhimin e tyre në këtë drejtim. Në Kosovë, kjo sfida dyfishohet, duke marrë për bazë edhe nivelin e ulët të aktivizimit qytetarë që ekziston aktualisht. Si pasojë, kredibiliteti i organizatës implementuese luan një rol të madh mbi angazhimin serioz të Ekipit të AS, gjatë gjithë periudhës së implementimit. Ngjashëm, legjitimiteti i organizatës implementuese krijuar gjatë kësaj kohe gjithashtu kontribuon në suksesin e këtij procesi. Që kjo e fundit të garantohet, organizata implementuese duhet të jetë në kontakt të vazhdueshëm me të gjithë anëtarët e ekipit, përmes kanaleve formale dhe informale, dhe t'i mbaj ata të informuar dhe aktiv me çdo kusht. Në vazhdim, organizata duhet të përkujdeset që të marrë për bazë të gjitha rekomandimet dhe sygjerimet e ekipit, por nuk duhet të përjashtoj pjesëtarët e tjerë të komunitetit që mund të përfitojnë nga projekti i monitoruar, por që nuk janë pjesë e këtij ekipi për arsye të ndryshme. Vlerësimi i nevojave të komunitetit dhe shtyerja përpara e rekomandimeve të tyre mbetet qëllimi kryesor i auditimit social dhe duhet të shërbej si parakusht gjatë gjithë fazave të implementimit. Mbi të gjitha, auditimi social është një proces që udhëhiqet nga komuniteti, nevojat e të cilëve mbeten parakusht për një performancë më të mirë të qeverive lokale.

Qëllimi i takimeve të rregullta të Ekipit të Auditimit Social:



HAPI 4: Identifikimi i përfaqësuesve komunal dhe organizimi i takimeve të rregullta me ta

Një proces i sukseshëm i auditimit social duhet të jetë gjithëpërfshirës. Në fund të ditës, janë institucionet lokale ato që bartin reformat dhe politikat e nivelit lokal dhe janë përgjegjëse për rezultatet finale në këtë drejtim. Në mënyrë që të arrihet ndikim në një proces të caktuar, përfaqësuesit lokal duhet të përfshihen qysh në fazat e hershme të implementimit, në të kundërtën, procesi i auditimit social do të dështoj. Në mënyrë që të sigurohet gjithëpërfshirje, organizata implementuese duhet të ndërmarrë disa hapa, përfshirë:

- ✓ Identifikimin e të gjithë akterëve relevant, përfshirë ata institucional, shoqërinë civile, iniciativat me bazë në komunitet dhe mediat,
- ✓ Organizimin e takimeve fillestare me përfaqësues komunal, e preferuar është që takimi i parë të jetë me Kryetarin e komunës, në mënyrë që të sigurohet përkrahja nga ai/ajo,
- ✓ Identifikimi i departamenteve përkatëse komunale që mund të jenë përgjegjëse për aspekte të ndryshme të zbatimit të projektit të përzgjedhur për monitorim (p.sh. Departamenti për Shërbime Shëndetësore, Departamenti për Shërbime Publike, Departamenti për Edukim, etj.), varësisht nga natyra e projektit,
- ✓ Departamenti për Prokurim duhet gjithmonë të jetë i përfshirë,
- ✓ Organizimi i takimeve fillestare me departamentet komunale përkatëse me qëllim të informimit të tyre mbi iniciativën dhe sigurimit të përkrahjes dhe bashkëpunimit përgjatë procesit, dhe
- ✓ Sigurimi që të gjitha palët e përfshira janë rregullisht të informuara mbi aktivitetet e Ekipit të Auditimit Social.



Takimet e rregullta me përfaqësues komunal kontribuojnë direkt në rritjen e bashkëpunimit mes qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre, një aspekt që mungon në Kosovë. Ato gjithashtu rrisin rolin qytetarë në procesin e vendimmarrjes në nivel komunal

Një tjetër aspekt i rëndësishëm për të arritur ndikimin e dëshiruar mbetet bashkëpunimi dhe përfshirja e mediave lokale. Në këtë drejtim, bashkëpunimi i mëhershëm ndërmjet organizatës implementuese dhe medias lokale është shumë i rëndësishëm, prandaj në seksionet e mëhershme të këtij Manuali diskutuam mbi rëndësinë e madhe të legjitimitetit dhe respektit që organizata gëzon në zonën ku vepron, përfshirë bashkëpunimin konstruktiv që duhet ta ketë me përfaqësuesit insitucional dhe mediat.

Përfshirja e mediave lokale gjatë procesit të monitorimit garanton që aktivitetet e implementuara nga Ekipi i Auditimit Social arrijnë tek një numër më i madh qytetarësh, duke arritur kështu impaktin e dëshiruar, sidomos në zonat më të thella ku mediat tradicionale shfrytëzohen më së shumti si kanale informimi. Në mënyrë që të arrihet përfshirja e mediave lokale, organizata implementuese duhet t'i mbaj ata rregullisht të informuar mbi aktivitetet dhe takimet e Ekipit të Auditimit Social, në mënyrë që ata të kenë mundësinë t'i mbulojnë këto aktiviteti dhe t'i shpërndajnë tutje tek komuniteti i një zone të caktuar. Në mënyrë që të arrihet në tërësi impakti i dëshiruar, organizata duhet doemos të sigurojë bashkëpunimin e medias gjatë tërë procesit të zbatimit të auditimit social dhe kurdo që është e mundur.

HAPI 5: Mbledhja e fakteve dhe dakordimi mbi rezultatet finale

Një nga elementet kyçe të auditimit social mbeten mbledhja e të gjitha fakteve, analizimi i tyre dhe dakordimi mbi vlerësimin përfundimtar. Siç është elaboruar më parë, kjo fazë e dytë është më e gjatë dhe më komplekse se të tjerat dhe aktivitetet e zbatuara gjatë kësaj fazë kanë si rezultat një vlerësim përfundimtar mbi të gjeturat e dala nga procesi i monitorimit dhe të dhënat e mbledhura nga periudha e hulumtimit. Ekipi i AS duhet të sigurojë një analizë të plotë të të gjitha të dhënave të mbledhura, duke identifikuar faktorët kryesorë dhe modelet që dëmtojnë besueshmërinë, efikasitetin dhe përgjegjshmërinë e aktiviteteve të prokurimit publik, nëse hasen të tilla.

Mbledhja e fakteve është një detyrë komplekse dhe shumë kërkuese. Organizata lokale që udhëheq procesin duhet të sigurojë një proces të lehtë dhe rregullisht t'i ofrojë ekipit ndihmën e nevojshme. Në krahasim me anëtarët e Ekipit të Auditimit Social, organizata lokale supozohet të ketë përvojë të gjerë në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, kështu që përfaqësuesit e tyre duhet të veprojnë si mentorë për Ekipin, dhe të rrisin kapacitetet e qytetarëve njëkohësisht.

Procesi duhet të përfshijë dy aspekte si mëposhtë:

ANALIZIMI I DOKUMENTACIONIT PËRKATËS – Gjatë takimeve të rregullta të Ekipit të Auditimit Social, organizata implementuese duhet të vë në dispozicion të ekipit të gjitha dokumentet relevante lidhur me projektin përkatës, dhe që të njëjtat janë rregullisht të analizuar dhe krahasuar me Matricën e Indikatorëve të Matjes së Performancës të hartuar në fazë më të hershme. Më konkretisht, Ekipi i Auditimit Social duhet të ketë qasje në të gjitha dokumentet publike të komunës (p.sh. projektin teknik, aspektet menaxheriale, të dhënat financiare, etj) në mënyrë që të arrij të vlerësoj nivelin e transparencës, efikasitetit dhe llogaridhënies së autoriteteve komunale.

Cilat janë dokumentet përkatëse që duhet të merren?

Që procesi të jetë vlerësuar mbi fakte dhe të dhëna të sakta, organizata implementuese duhet të disponojë të gjitha dokumentet relevante mbi projektin e përzgjedhur. Pavarësisht a është projekt infrastrukturor apo ofrim shërbimesh, dokumentet kryesore që duhet të merren janë:

- ✓ Të gjitha dokumentet përkatëse të prokurimit (përfshirë procedurën e tenderimit, thirrjen e hapur të prokurimit, kriteret e përzgjedhjes, etj.)
- ✓ Kontratet finale të nënshkruar nga të dyja palet, Komuna dhe kompania fituese;
- ✓ Planin kohor të implementimit të projektit;
- ✓ Planin e fizibilitetit, nëse ka;
- ✓ Buxhetin e detajuar të projektit, përfshirë linjat buxhetore për secilin aktivitet dhe fazë të implementimit;
- ✓ Të gjitha kontratat me nën-kontraktorë, nëse ka;
- ✓ Të gjitha raportet financiare mbi projektin;
- ✓ Dizajnin e projektit mbi të cilin është dhënë kontrata.

FAZA 2 – Procesi i Mbledhjes së Informacionit

ORGANIZIMI I VIZITAVE NË TERREN – Një nga mënyrat më të mira për të vlerësuar realitetin është organizimi i vizitave në terren në ato raste kur Ekipi i Auditimit Social është duke monitoruar një projekt infrastrukturor (p.sh. ndërtimi i një shkolle të re, renovimi i qendrave të mjekësisë familjare, revitalizim të parkut, etc.). Në këtë drejtim, organizata implementuese duhet të organizojë vizita të rregullta në vendet ku po ndërtohet së bashku me të gjithë anëtarët e ekipit, sepse të tillat janë njëjtë të rëndësishme sa mbledhja e fakteve dhe analizimi i dokumenteve të ndryshme, dhe e kompletojnë hulumtimin si tërësi. Vëllimi i vizitave mund të ndryshojë varësisht nga intensiteti i implementimit të projektit apo sfidat e hasura gjatë periudhës së monitorimit. Thënë këtë, organizata implementuese duhet të jetë shumë e kujdesshme që të organizojë vizita në terren saherë që kjo shihet të jetë e nevojshme për një vlerësim të drejtë të fakteve.

Vizita në terren mund të organizohen edhe në ato raste kur Ekipi i Auditimit Social është duke monitoruar një shërbim që ofrohet nga autoritetet komunale. Edhe pse shumica e qytetarëve të një komuniteti janë mjaft të vetëdijshëm mbi cilësinë e ofrimit të shërbimeve nga ana e komunës duke qene përdorues të rregullt të këtyre shërbimeve, në disa raste komuna hap aktivitete prokurimi me qëllim të përmirësimit të ofrimit të një shërbimi të caktuar. Në mënyrë që të vlerësohet drejtë ky aktivitet prokurimi, Ekipi i Auditimit Social duhet të organizoj vizita të rregullta në insitucionet/vendet përkatëse që ofrojnë atë shërbim të caktuar, në mënyrë që të testojnë nëse këto përmirësime janë arritur dhe janë të prekshme. Foto dhe videot gjithashtu janë një formë shume efikase për të mbajtur evidencë të rregullt mbi progresin e arritur gjatë periudhës monitoruese. Në përgjithësi, terreni i mundëson ekipit që në mënyrë të drejtpërdrejtë të monitoroj dhe vlerësoj drejtë implementimin e një iniciative të caktuar komunale.

DAKORDIMI MBI REZULTATET FINALE TË VLERËSIMIT – Sapo të gjitha aspektet e monitorimit të jenë përmbyllur, organizata implementuese duhet të mbledh Ekipin e Auditimit Social për një takim përfundimtar për të diskutuar mbi të gjitha të gjeturat e dala nga periudha e monitorimit. Është shumë e rëndësishme që para këtij takimi, organizata implementuese të planifikojë një strukturë të qartë të këtij diskutimi të gjatë dhe përfundimtar. Më konkretisht, organizata duhet të hartojë një numër pikash diskutimi mbi të cilat do ndërtohen vlerësimet përfundimtare nga të gjeturat në dispozicion. Ekipi i Auditimit Social duhet t'a ketë të qartë që një vlerësim i tillë nuk po bëhet në baza 'ad-hoc' por vjen si rezultat i një procesi të gjatë të monitorimit të përbashkët. Të gjitha të dhënat nga tereni dhe ato nga takimet duhe të analizohen dhe diskutohen thellësisht gjatë këtij takimi përfundimtar, dhe të gjithë

anëtarët duhet të informohen se vlerësimet e dala në këtë takim do reflektohen në tërësi në raportin final i cili do bëhet publik në fund të projektit.

Në mënyrë që të dhënat të prezantohen siç duhet, rekomandohet që diskutimi të jetë i strukturuar në mënyrë sa më të thjeshtë të mundshme. Duke konsideruar këtë, sapo të gjitha të dhënat të jenë në dispozicion, ekipi duhet të ndajë ato në aspektet pozitive dhe ato negative dhe të reflektojë në një tabelë të thjeshtë. Sapo të dhënat të jenë ndarë, ekipi së pari duhet të vlerësoj dhe pranojë të gjitha aspektet pozitive, dhe pastaj, t'ia kushtojë tërë kohën e mbetur të gjitha sfidave të hasura dhe aspektet negative të dala nga periudha e monitorimit. Ky lloj konstruktivi i të dhënave i mundëson ekipit që të analizojë më tërthorazi situatën aktuale dhe se si të procedojë tutje dhe të avokoj mbi këto të gjetura tek autoritetet lokale, gjithnjë duke tentuar që të përmirësoj një projekt apo inicativë të caktuar.


KËSHILLA SHITESË! – Faza 2

- Në mënyrë që auditimi social të ketë sukses, sigurohuni që disa nga anëtarët e Ekipit të Auditimit Social janë zëra aktiv në komunitetin e tyre dhe kanë aftësi të dukshme të liderit;
- Sigurohuni që takimet të mos shtyhen apo zvoglohen në numër në krahasim me planin fillestar! Është shumë e rëndësishme të organizohen sa më shumë takime që është e nevojshme në mënyrë që ekipi të jetë sa më aktiv;
- Takimet e Ekipit të Auditimit Social duhet të jenë të strukturuar mirë në mënyrë që diskutimet të prodhojnë rezultate konkrete;
- Takimet bilaterale me përfaqësuesit komunal janë po aq të rëndësishme. Mbetet parakusht për organizatën implementuese që të koordinojë dhe organizojë sa më shumë takime mes Ekipit të Auditimit Social dhe përfaqësuesve komunal;
- Gjatë procesit, organizata implementuese duhet vazhdimisht të angazhohet në rritje e kapaciteteve analitike dhe profesionale të anëtarëve të ekipit, duke ju ofruar atyre ekspertizë të rregullt dhe një platformë diskutimi mbi procesin e monitorimit dhe vlerësimin;
- Duhet të jeni të adaptueshëm! Jo të gjitha aktivitetet realizohen sipas planit fillestar. Shume shpesh, një proces i suksesshëm i auditimit social kërkon më shumë angazhim sesa është planifikuar fillimisht;
- Gjithmonë mbani mend se Ekipi i Auditimit Social është duke u angazhuar në baza vullnetare dhe sigurohuni t'a vlerësoni këtë fakt gjatë procesit.

FAZA 3 - Dialogu publik dhe publikimi i të gjeturave


Një vlerësim pa një debat të duhur publik nuk e arrin asnjëherë impaktin e dëshiruar. Një nga parimet kryesore të auditimit social është inkurajimi i aktivizmit qytetarë, identifikimi i sfidave dhe veprimeve të dëmshme nga ana e qeverive lokale, dhe atribrimi i meritave tek komuna në raste të veprimeve pozitive përmes iniciativave të ndërmarra.

Auditimi social i mundëson komunitetit që të shëndrrohen në lider të monitorimit të autoriteteve lokale dhe u mundëson atyre që përmes 'efektit zinxhir' t'i fuqizojnë anëtarët e tjerë të komunitetit për t'u angazhuar në aktivitete të ngjashme. Më e rëndësishmja, u mundëson atyre që të ngrisin vetëdijen qytetare mbi rolin kyç që kanë mbi të drejtën e tyre për të mbajtur përgjegjës të zgjedhurit e tyre në nivel lokal.



Organizata implementuese, së bashku me Ekipin e Auditimit Social, duhet të përkujdesen që të gjeturat dhe vlerësimet finale të prezantohen në mënyrë të duhur tek të gjithë akterët relevant, dhe sidomos tek publiku si përfituesit përfundimtar të këtyre shërbimeve

Në Kosovë, nevoja për të arritur tek një numër sa më i madh qytetarësh është edhe më e rëndësishme. Duke konsideruar faktin që auditimit social si mjet mbetet shumë i panjohur si për qytetarë ashtu edhe për institucionet, publikimi i suksesshëm i rezultateve përfundimtare mbetet aspekt kyç lidhur me rritjen e vetëdijës mbi mjete të tilla inovative të ngritjes së llogaridhënies institucionale. Ky Manual ofron hapa të detajuar mbi publikimin e suksesshëm të të gjeturave dhe rezultateve finale.



HAPI 1: Hartoni një strategji komunikimi për të publikuar të gjeturat e auditimit social.

Nëse një proces i caktuar i auditimit social është i suksesshëm varet shumë nga strategjia e duhur e publikimit dhe shpërndarjes të gjetjeve kryesore që rrjedhin nga periudha e monitorimit. Një strategji e duhur e publikimit dhe komunikimit me publikun duhet të marrë parasysh disa aspekte si mëposhtë:

Përditësimi i rregullt i platformave të rrjeteve sociale dhe mjeteve të tjera ekzistuese të komunikimit lidhur me aktivitetet e ndërmarra nga Ekipi i Auditimit Social;

Dizajnimi dhe përfundimi i infografikave të ndryshme në mënyrë që të dhënat të jenë më vizuale dhe atraktive për lexuesit;

Kurdo që është e mundur, të realizohen video dokumentar të shkurtër dhe fotografi të cilat mbulojnë tërë procesin e auditimit social dhe shpërndahen tek një publik sa më i gjërë;

Prononcimet në media, kurdo që është e mundur. Media mbetet një nga akterët kyç që ndihmon në shpërndarjen e mëtutjeshme të rezultateve tek publiku.

HAPI 2: Organizoni takime të shumta mes ekipit të as dhe përfaqësuesve komunal.

Edhe pse takimet midis Ekipit të Auditimit Social dhe përfaqësuesve komunal duhet të organizohen në baza të rregullta, duke u afruar nga fundi i projektit, këto takime duhet të jenë edhe më të shpeshta. Në fazën e fundit të procesit të monitorimit, Ekipi i Auditimit Social posedon më shumë të dhëna mbi progresin e zbatimit të projektit dhe është më e lehtë për ta të argumentojnë mbi ndryshimet e nevojshme dhe të ofrojnë rekomandime konkrete për përfaqësuesit e komunës. Është e rekomanduar që para se të organizohet ngjarja përmbyllëse e projektit, Ekipi i Auditimit Social të caktojë një takim me përfaqësuesit e komunës në mënyrë që t'i konsultoj ata mbi të gjeturat preliminare të dala nga procesi i monitorimit. Është e rëndësishme që në këtë takim të ketë sa më pjesëmarrës që është e mundur, si nga Ekipi i AS, poashtu edhe nga departamentet përkatëse brenda komunës. Nëse media nuk është prezente gjatë këtyre takimeve finale, ekipi i projektit duhet të lëshoj një komunikatë për media pas çdo takimi, e cila do përfshinte pikat kryesore të dala nga diskutimi përkatës.



HAPI 3: Rekomandohet të organizohet një diskutim publik përmblyës me të gjithë aktorët relevant.

Tryeza përmblyëse duhet të shërbejë si aktiviteti final i projektit të implementuar nga Ekipi i Auditimit Social. Kjo tryezë duhet të shërbejë si platformë për të shpërndarë të gjeturat përfundimtare të projektit tek publiku i gjërë. Edhe pse një tryezë e tillë vjen me implikime financiare, organizimi i një diskutimi të tillë rekomandohet po qe e mundur. Nëse organizata nuk i posedon mjetet financiare për një organizim të tillë, rekomandohet të shqyrtohen alternative me sa më pak shpenzime, siç mund të jetë edhe organizimi i saj në sallën e Asamblesë Komunale e cila lëshohet në shfrytëzim pa pagesë.

Që tryeza finale të organizohet siç duhet, organizata implementuese duhet të ndërmarrë këto aktivitetet:

1. Të sigurohet që paneli është gjithëpërfshirës. Paneli duhet të përfshijë një përfaqësues të komunës (p.sh. kryetarin e komunës apo drejtorët e departamenteve përkatëse që janë përgjegjës për implementimin e projektit të monitoruar nga Ekipi i AS). Në vazhdim, paneli duhet të përfshijë një apo dy anëtarë të Ekipit të AS, varësisht nga madhësia e grupit që është përfshirë në monitorim të projektit.
2. Të sigurohet një moderator profesional dhe të aftë për të drejtuar diskutimin. Diskutimi gjatë tryezës finale duhet të jetë i strukturuar në mënyrë që të prodhohin inpute konkrete. Në fillim të diskutimit, organizata implementuese duhet të prezantojë raportin final i cili duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe me të gjetura konkrete. Kurse moderatorin duhet të angazhohet gjatë tërë kohës në lehtësimin dhe strukturimin e diskutimit për pjesën e mbetur të tryezës, në mënyrë që diskutimi të arrijë ndikimin e dëshiruar.
3. Të sigurohet pjesëmarrje e gjërë. Përveq panelit profesional dhe anëtarëve të Ekipit të AS, ftesa duhet të ju dërgohet edhe një listë me të gjërë të pjesëmarrësve potencial. Thënë këtë, ftesa duhet të arrijë tek tërë komuniteti i asaj zone, tek departamentet e tjera të komunës përkatëse, organizatat e shoqërisë civile, aktivistë të ndryshëm, komuniteti ndërkombëtar dhe ekspertët e fushës.
4. Të sigurohet mbulim medial. Që tryeza përmblyëse të arrijë tek një masë më e gjërë qytetarësh, mbulimi mediatik mbetet i një rëndësie shumë të madhe. Si rezultat, organizata implementuese duhet të nis një ftesë për media tek të gjithë mediat lokale dhe qendrore një ditë para tryezës përmblyëse, si dhe duhet të angazhohet që përmes telefonit të konfirmojë prezencën e tyre, po qe nevojta.
5. Të publikohen infografikat. Nëse raporti final përfshin edhe sete infografikash, është shumë e rëndësishme që të njejtat të printohen dhe publikohen edhe veçmas nga raporti si dhe të jenë të shfaqura në ekran gjatë gjithë kohës së diskutimit. Poashtu, preferohet që versioni i printuar të jetë i qasshëm në të gjitha gjuhët lokale dhe të shpërndahet tek të gjithë të pranishmit.
6. Të publikohet dokumentari i shkurtër, nëse është prodhuar. Ngjashëm si me infografikat, po qe e mundshme, rekomandohet që projekti të realizoj një dokumentar të shkurtër përmes së cilit dokumentohet e gjithë kronologjia e procesit të monitorimit dhe rezultatet finale. Nëse një video e tillë është realizuar, ajo duhet të shfaqet gjatë tryezës përmblyëse.
7. Dërgoni një komunikatë për media. Pasi që tryeza të ketë përfunduar, organizata implementuese duhet të lëshojë një komunikatë për media që përmbledh pikat kryesore të diskutimit dhe qëndrimet e dalta nga paneli. Komunikata për media duhet të dërgohet tek të gjitha mediat lokale dhe qendrore, në mënyrë që të arrihet më shumë ndikim.
8. Përdorni platformat e rrjeteve sociale gjatë tryezës. Në mënyrë që të targetohen drejtë të gjitha grupet e targetuara, organizata implementuese duhet të përdorë edhe rrjetet sociale, dhe në mënyrë aktive të postojë në secilën platformë, sidomos gjatë kohës së diskutimit final.
9. Falenderoni pjesëmarrësit pas diskutimit. Pas përmblyes së projektit, provoni të ruani bashkëpunimin me pjesëmarrësit dhe aktorët relevant duke ju nisur atyre një Letër Falenderimi mbi kontributin e dhënë gjatë fazës së implementimit të projektit, dhe në të njëjtën kohë ju dërgoni edhe të gjitha publikimet relevante (raportin final, infografikat, dokumentarin, etj.

HAPI 4: Koordinoni dialogun publik midis qytetarëve dhe përfaqësuesve komunal.

Pas implementimit të një procesi të auditimit social, gjithmonë duhet të ketë një vjueshmëri të mëtutjeshme edhe pas përfundimit të të gjitha aktiviteteve. Organizata implementuese duhet që të angazhohet edhe pas përmbylljes së projektit në mënyrë që të sigurohet që dialogu publik mes qytetarëve dhe përfaqësuesve komunal është duke vazhduar edhe pas procesit të monitorimit. Mbi të gjitha, duhet të vlerësoj nëse rekomadimet e dala nga Ekipi i AS janë duke u adresuar në mënyrë të duhur nga ana e komunës përkatëse. Në vazhdim, një qasje e tillë i kontribuon edhe më tutje përmirësimit të llogaridhënies dhe transparencës nga ana e qeverive lokale. Në këtë drejtim, organizata implementuese duhet të organizoj takime mes komunitetit dhe përfaqësuesve komunal sa herë që ka mundësi, edhe pas përmbylljes së projektit. Në këtë mënyrë komuniteti do ketë mundësi të diskutoj me përfaqësuesit e vet mbi shqetësime të ndryshme që mund të kenë lidhur me shërbimet komunale. Po që se rekomadimet nuk janë marrë parasysh, ekzistojnë edhe alternativa të tjera të rritjes së presionit publik sikurse përdorimi i mediave, organizimi i forumeve publike, rrjetet sociale, emailët e vazhdueshme, dhe platforma të tjera që mund të ekzistojnë për këtë qëllim.


KËSHILLA SHITESË! – Faza 3

- > Nëse posedoni buxhet të mjaftueshëm, këshillohet që të punësoni një fotograf profesional për të gjitha takimet që organizohen gjatë periudhës së monitorimit. Njësoj, një dokumentar i shkurtër që pasqyron kronologjinë e monitorimit është gjithashtu shumë i rekomanduar.
- > Organizata duhet të ketë një strategji të qartë komunikimi qysh në fazat e hershme të implementimit të projektit. Kjo strategji duhet të ndahet dhe konsultohet me të gjithë anëtarët e Ekipit të Auditimit Social, qysh në fazat e hershme të projektit.
- > Rrjetet sociale duhet të përdoren rregullisht, si mjete komunikimi me publikun por edhe palët e tjera të interesit.
- > Mediat duhet të jenë një ndër partnerët kryesor dhe duhet të mbahen të informuar rregullisht mbi aktivitetet e projektit të auditimit social.



FAZA 4 - Përcjellja dhe ruajtja e momentit pas përfundimit të projektit

Organizata implementuese dhe anëtarët e Ekipit të Auditimit Social rekomandohet të angazhohen edhe pasi projekti të ketë përfunduar. Të dyja palët duhet të shtyejnë tutje të gjeturat dhe rekomandimet e tyre deri në pikën kur komuna i adreson ato siç kërkohet. Në këtë rast duhet të kërkohet edhe përkrahja e mediave lokale si dhe duhet të përdoren të gjitha platformat sociale në mënyrë që të avokohet tutje që rezultatet të arrihen deri në pikën siç janë propozuar.



Organizata implementuese dhe Ekipi i Auditimit Social duhet të shfrytëzojnë historinë e tyre të suksesit dhe t'a prezantojnë atë në komunitet në mënyrë që t'i inkurajojnë të tjerët që të përdorin auditimin social si mjet i cili u mundëson atyre një mirëqenie më të mirë!

Është shumë e rekomanduar që Ekipi i Auditimit Social të vazhdoj tutje komunikimin me përfaqësuesit e komunës përkatës në mënyrë që të vlerësoj nëse rekomandimet e tyre janë marrë parasysh në realitet. Rekomandimet dhe të gjeturat duhet të jenë konkrete dhe të bazuara në fakte solide.

SHEMBUJ TË TË GJETURAVE

Të gjeturat

- Mosrespektimi i standarteve të kontratës
- Gabime në projekt
- Pjesë të rrezikshme të parkut
- Mungesa e një udhëheqësi të projektit



Të gjeturat

- Pjesë të rrezikshme në fushat sportive
- Mungesë e shkallëve për shpëtim nga zjarri
- Kushte jo adekuate për mësim për fëmijët në nivelin parashkollor
- Rrezikshmëria nga qentë endacak
- Kanalet e hapura paraqesin rrezik për fëmijët



Implementuesi i projektit dhe anëtarët e ekipit duhet të përkujdesen që raporti i dal nga procesi i monitorimit të mos mbetet vetëm një dokument më shumë në raftet e zyrës së komunës përkatëse.

Është shumë e zakonshme që në shtetet në zhvillim insitucionet përkatëse të mos marrin fare parasysh rekomandimet e dhëna nga një grup i vogël qytetarësh, dhe sidomos në Kosovë, ku aktivizmi qytetar është i ulët dhe duhet inkurajuar. Si rezultat, pas përfundimit të projektit, është e detyrueshme që ekipi të rievlerësoj nëse rekomandimet e tyre janë pranuar në mënyrë që qytetarët të përfitojnë siç duhet nga ky angazhim.

Është shumë e rëndësishme që të gjinden mënyra për t'a ruajtur momentin dhe për të siguruar që autoritetet lokale janë duke adaptuar rekomandimet e dala nga procesi i auditimit social.


FAZA 4 - Përcjellja dhe ruajtja e momentit pas përfundimit të projektit

Në mënyrë që kjo të arrihet, organizata implementuese duhet të ndërmarrë disa masa si më poshtë:

- ✓ Sapo procesi i auditimit social të ketë përfunduar, pas një periudhe të caktuar (më së shumti 6 muaj) organizata implementuese duhet të organizojë një tryezë të vogël diskutimit mes Ekipit të Auditimit Social, përfaqësuesve komunal dhe pjesëtarëve të tjerë të komunitetit të asaj zone të caktuar, me qëllim që të vlerësohet nëse rekomandimet janë zbatuar në tërësi dhe siç janë premtuar në fillim.
- ✓ Nëse autoritetet lokale nuk kanë arritur të përmbushin premtimet e dhëna, organizata lokale duhet të gjej mënyra për të rritur 'presionin publik', dhe një gjë e tillë mund të arrihet përmes prononcimeve në media dhe përdorimit të rregullt të rrjeteve sociale.
- ✓ Nëse një situatë e tillë krijohet, shqetësimet mbi mospërmbushjen e premtimeve duhet të ndahen edhe me komunitetin e gjërë në mënyrë që presioni të mos limitohet në vetëm një organizatë lokale të shoqërisë civile.

KËSHILLA SHITESË! – Faza 4

- > Nëse ekipi ballafaqohet me sfida të tilla, përkrahja nga organizatat tjera lokale si dhe ato qendrore është shumë e rekomanduar
- > Të përdoren vazhdimisht platformat sociale, janë metoda më e shpejtë dhe më e lirë për të rritur presionin publik
- > Të bashkëpunohet rregullisht me mediat lokale dhe qendrore
- > Ekipi i projektit duhet të reflektojë dhe të mësojë nga sfidat e hasura gjatë procesit të implementimit të auditimit social



VLERËSIMI I RREZIQEVE DHE SFIDAVE: Cfarë duhet të ketë parasysh një organizatë lokale?

Një organizatë e cila synon të përdor auditimin social në Kosovë duhet të konsideroj një numër çështjesh që mund të krijojnë rrisqe dhe sfida gjatë fazës së zbatimit të projektit. Ky Manual Praktik numëron disa nga aspektet që mund të dëmtojnë procesin dhe suksesin e përgjithshëm të auditimit social, në përgjithësi.

RREZIKU	LEHTËSIMI
Mungesa e vullnetit politik për të bashkëpunuar me Ekipin e Auditimit Social	<ul style="list-style-type: none"> – Organizata implementuese duhet vazhdimisht të angazhohet në rritjen e bashkëpunimit me përfaqësuesit komunal dhe të pranojë rolin e tyre si udhëheqës të procesit për implementim të një iniciative të caktuar komunale – Qeveritë lokale duhet të vetëdijësohen që përmirësimi i mirëqenies së qytetarëve nënkupton prosperitet, mundësi për investime të huaja direkte dhe zhvillim ekonomik të një rajoni të tërë
Mungesa e vullnetit qytetarë për t'u angazhuar në një proces të auditimit social	<ul style="list-style-type: none"> – Organizata implementuese duhet të informoj dhe inkurajoj qytetarët mbi rolin e tyre të rëndësishëm në kërkim të të drejtave të tyre të dhëna edhe me Kushtetutë – Atyre duhet të ju komunikohet që rezultatet e arritura gjatë procesit do ndikojnë direkt në përmirësimin e jetës dhe mirëqenies së tyre – Qytetarët duhet të informohen që auditimi social vendos qytetarin në zemër të procesit dhe legjitimon zërin e tyre
Organizata lokale has në vështirësi në sigurimin e dokumenteve përkatëse	<ul style="list-style-type: none"> – Qasja në dokumentet përkatëse mbetet thelbësore për procesin – Organizata lokale duhet të kërkoj me çdo kusht qasje në dokumente publike të komunës, duke u bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike të Republikës së Kosovës
Interesi dhe vullneti i anëtarëve të Ekipit të Auditimit Social bie pas një kohe	<ul style="list-style-type: none"> – Në mënyrë që të menjanohet ky rrezik dhe të sigurohet një ekip përfaqësues, organizata implementuese duhet gjithmonë të mbaj një listë rezervë të antarëve të rinjë të mundshëm dhe ti të jetë e gatshme t'i integrojë ata në cilëndo fazë të implementimit
Mungesa e mbulueshmërisë mediale	<ul style="list-style-type: none"> – Mediat duhet të mbahen gjithnjë të informuara dhe të familiarizohen me procesin e auditimit social – Ftesat e rregullta dhe komunikatat për media janë të detyrueshme
Mungesa e kapaciteteve njerëzore	<ul style="list-style-type: none"> – Organizata implementuese duhet gjithnjë të angazhohet në ngritjen e kapaciteteve të ekipit të saj dhe t'i trajnoj ata se si implementohen mjetet e llogaridhënies sociale – Ngritja e kapaciteteve të hulumtimit dhe avokimit të ekipit të organizatës është gjithashtu një aspekt i rëndësishëm, sepse gjatë procesit të auditimit social do implementohen shumë aktivitete të avokimit dhe analizës së të dhënave
Mungesa e kapaciteteve financiare	<p>Organizata duhet rregullisht t'i qaset donatorëve potencial dhe të kërkoj fonde mbi dy premisa:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mjetet e llogaridhënies social janë metoda inovative për të rritur transparencën dhe llogaridhënien institucionale 2. Auditimi social fuqizon qytetarët dhe organizatat lokale të shoqërisë civile

PËRFUNDIM

Në vendet në zhvillim sikurse Kosova, aktivizmi qytetarë mbetet thelbësor në përmirësimin e llogaridhënies dhe performancës së përgjithshme të institucioneve shtetërore. Në vende të ndryshme të botës, mjetet e llogaridhënies sociale kanë prodhuar rezultate të mahnitshme në ato raste kur janë aplikuar siç duhet. Shumë shkolla janë ri-projektuar, shërbime të ndryshme janë përmirësuar, dhe projekte të shumta infrastruktore ju kanë lehtësuar jetën komunitetit, me anë të përdorimit të këtyre mjeteve të llogaridhënies sociale.

A është koha që edhe organizatat e shoqërisë civile në Kosovë, por edhe institucionet, të përdorin këto mjete në mënyrë që të përfaqësojnë më mirë komunitetin e tyre?

Ky Manual Praktik ofron një numër të madh sqarimesh mbi faktin që OShC-të në Kosovë, në një kohë shumë të shkurtër, të konsiderojnë përdorimin e këtyre mjeteve dhe të fuqizojnë tutje komunitetin në zona të ndryshme të Kosovës.

A janë të gatshme organizatat lokale në Kosovë që të implementojnë koncepte të tilla inovative? Edhe pse mjaft të limituara në kapacitete, OShC-të lokale janë plotësisht të afta që ti adaptojnë mjetet e ndryshme të llogaridhënies sociale, me ndihmë edhe të komunitetit dhe donatorëve ndërkombëtarë.

Në anën tjetër, edhe institucionet lokale dhe ato qendrore duhet të angazhohen njëkohësisht që t'i pranojnë këto mjete dhe të sigurohen që shërbimet e ofruara përmirësohen vazhdimisht, dhe efikasiteti i institucioneve është rritur edhe me përfshirjen dhe konsultimin direkt të qytetarëve gjatë procesit të dizajnit dhe implementimit të politikave shtetërore.

Pra, cilat janë disa nga aspektet kryesore që e bejnë një organizatë lokale të aftë për të implementuar koncepte të tilla inovative?

Ky Manual Praktik argumenton mbi shumë aspekte, por kredibiliteti i organizatës mbetet elementi kyç në këtë drejtim. Nëse një organizatë lokale gëzon reputacion të mirë në zonën që përfaqson, mobilizimi i komunitetit nuk do të paraqes problem gjatë procesit të implementimit të mjeteve të tilla.

Përderisa një organizatë implementon të gjitha fazat e dhëna në këtë manual, dhe gjithashtu hulumton mbi praktikatat më të mira në vende të tjera të botës, çdo mjet i llogaridhënies sociale do të prodhojë ndikimin e dëshiruar. Si përfundim, një organizatë e shoqërisë civile asnjëherë nuk duhet të harroj që auditim social vë qytetarin në pedestal dhe është një proces plotësisht i udhëhequr nga qytetarët audit puts citizens first, as it is led by citizens.

